

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 21.01.2023

DETYRA 1

- a) Në vijim paraqiten të dhënat nga Pasqyra e Pozicionit Financiar të kompanisë Alfa shpk, më 31 dhjetor 2021:

Pasuritë jo qarkulluese

	Kosto	Zhvlerësimi i akumuluar	Vlera neto në libra
	eur	eur	eur
Pajisjet e zyrës	172,800	92,100	80,700

Gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2022, kanë ndodhur transaksionet e mëposhtme në lidhje me pajisjet e zyrës:

Shitjet:

	Data e shitjes	Data e blerjes	Kosto e blerjes	Arkëtimet nga shitja
			eur	eur
Pajisja 1	31 Mars 2022	1 Janar 2019	22,000	4,000
Pajisja 2	30 Qershor 2022	1 Janar 2018	30,000	5,100

Blerjet:

	Data	Kosto
		Eur
Pajisja 3	1 Tetor 2022	35,000

Zhvlerësimi i pajisjeve të zyrës ngarkohet duke përdorur metodën drejtvizore për 5 vite dhe kanë vlerë të mbetur prej 10% e kostos së blerjes.

Kompania aplikon zhvlerësimin e pjesshëm për këto pajisje, pra prej datës së blerjes deri në datën e shitjes. Të gjitha transaksionet ishin bërë me para të gatshme.

Kërkohet:

- Përgatitni regjistrimet në ditar për shitjet dhe blerjet **(8 pikë)**
- Kalkulo shpenzimet e zhvlerësimit për vitin 2022, tregoni kontot T relevante për pasuritë dhe tregoni se si paraqiten në Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022. **(12 pikë)**

Totali 20 pikë

ZGJIDHJE DETYRA 1

1) Kalkulimet dhe regjistrimet----- Pajisja 1:

Vlera e mbetur= $22,000 \cdot 10\% = 2,200$

Zhvlerësimi vjetor= $(\text{Kosto}-\text{Vlera e mbetur})/\text{Vitet}=(22,000-2,200)/5 \text{ vite}=3960$

Zhvlerësimi i akumuluar (2019,2020,2021)=3 vite * 3960=11,880

Zhvlerësimi i akumuluar për 3 muaj të 2022= $3960/12 \cdot 3=990$

Total zhvlerësimi i akumuluar= $11,880+990=12,870$

Vlera shitëse	4,000
<u>VNL në datën e shitjes (22,000-12,870)</u>	<u>9,130</u>
<u>Humbja kapitale</u>	<u>5,130</u>

Regjistrimi:

Debi: Paraja e gatshme 4,000

Debi: Zhvlerësimi i akumuluar 12,870

Debi: Humbja kapitale 5,130

Kredi: Pajisja (Kosto) 22,000

Kalkulimet dhe regjistrimet----- Pajisja 2:

Vlera e mbetur= $30,000 \cdot 10\% = 3,000$

Zhvlerësimi vjetor= $(\text{Kosto}-\text{Vlera e mbetur})/\text{Vitet}=(30,000-3,000)/5 \text{ vite}=5,400$

Zhvlerësimi i akumuluar (2018,2019,2020,2021)=4 vite * 5,400=21,600

Zhvlerësimi i akumuluar për 6 muaj të 2022= $5,400/12 \cdot 6=2,700$

Total zhvlerësimi i akumuluar= $21,600+2,700=24,300$

Vlera shitëse	5,100
<u>VNL në datën e shitjes (30,000-24,300)</u>	<u>5,700</u>
<u>Humbja kapitale</u>	<u>600</u>

Regjistrimi:

Debi: Paraja e gatshme	5,100	
Debi: Zhvlerësimi i akumuluar	24,300	
Debi: Humbja kapitale	600	
		Kredi: Pajisja (Kosto)
		30,000

Regjistrimet e blerjes së pajisjes:

Debi:Pajisja	35,000	
		Kredi: Paraja e gatshme
		35,000

2) Kalkulimi i shpenzimeve të zhvlerësimit:

Pajisjet tjera me kosto: $172,800 - 22,000 - 30,000 = 120,800$

Vlera e mbetur= $10\% * 120,800 = 12,080$

Zhvlerësimi vjetor i pasurive tjera= $(120,800 - 12,080) / 5 \text{ vite} = 21,744$

Zhvlerësimi për 3 muaj i pajisjes 1=990 (shih më lartë)

Zhvlerësimi për 6 muaj i pajisjes 2=2,700 (shih më lartë)

Zhvlerësimi për 3 muaj i pajisjes 3=1,575 (shih më poshtë)

Total shpenzimi i zhvlerësimit për pajisjet për vitin 2022= $21,744 + 990 + 2,700 + 1,575 = 27,009$

Pajisja 3:

Vlera e mbetur= $10\% * 35,000 = 3,500$

Zhvlerësimi vjetor= $(35,000 - 3,500) / 5 \text{ vite} = 6,300$

Zhvlerësimi për 3 muaj (Tetor-Dhjetor) i pajisjes 3= $6,300 / 12 * 3 = 1,575$

Pajisjet (KOSTO)

Data	Detajet	Shuma	Data	Detajet	Shuma
1 Janar	Saldo në fillim	172,800	31 Mars	Shitja	22,000
1 Tetor	Paraja	35,000	30 Qershor	Shitja	30,000
			31 Dhjetor	Saldo në fund	155,800
		207,800			207,800

Zhvlerësimi i akumuluar i pajisjeve

Data	Detajet	Shuma	Data	Detajet	Shuma
31 Mars	Shitja	12,870	1 Janar	Saldo në fillim	92,100
30 Qershor	Shitja	24,300	31 Dhjetor	Shpenzimet e zhvlerësimit	27,009
31 Dhjetor	Saldo në fund	81,939			
		119,109			119,109

Ekstrakt nga Pasqyra e pozicionit financiar për Pasuritë jo qarkulluese më 31/12/2022

	Kosto	Zhvlerësimi i akumuluar	Vlera neto në libra
	eur	eur	eur
Pajisjet e zyrës	155,800	81,939	73,861

DETYRA 2

Në vijim paraqiten saldot nga librat e kompanisë Avioni shpk më 30 Prill 2021.

Eur

Shitjet	134,200
Blerjet	62,300
Stoqet më 1 maj 2020	4,700
Zbritjet e marra	390
Zbritjet e lejuara	240
Shpenzimet e pagave	12,700
Shpenzimet e qerasë	8,100
Shpenzimet motorike	7,500
Shpenzimet e riparimit	14,200
Shpenzimet e përgjithshme	2,600
Makineritë me kosto	45,000
Zhvlerësimi i akumuluar për makineritë më 1 Maj 2020	8,000
Automjetet me kosto	30,000
Zhvlerësimi i akumuluar për automjetet më 1 Maj 2020	6,000
Banka	4,400
Llogaritë e arkëtueshme	4,600
Llogaritë e pagueshme	2,200
Tërheqjet	7,400
Kapitali më 1 Maj 2020	52,950

Pas paraqitjes së këtyre saldove, janë zbuluar gabimet e mëposhtme:

- i) Një shitje me afat për klientin Aurora shpk në shumë prej 800 eur, është regjistruar në të gjitha kontot si 80 eur.
- ii) Blerja e një automjeti të ri me kosto prej 15,000 eur është regjistruar si debi në konton e Blerjeve të mallit.
- iii) Nuk është regjistruar fare në libra blerja e mallrave me afat nga furnitori Amelia shpk, në shumë prej 600 eur.
- iv) Një faturë e paguar me para për shpenzimet motorike në shumë prej 435 eur është regjistruar në librin e arkës dhe në shpenzimet si 475 eur.
- v) Nuk është regjistruar fare në libra shitja e mallrave me afat prej 1,000 eur.
- vi) Një pagesë për shpenzimet e përgjithshme në shumë prej 689eur ishte regjistruar në librin e arkës dhe në shpenzimet e përgjithshme si 698 eur.
- vii) Blerja e makinerisë prej 8,500eur ishte debituar në llogarinë e shpenzimeve të riparimit.

KËRKOHET:

1.Përgatitni hyrjet korigjuese në ditar për të korigjuar gabimet e lartpërmendura (7 pikë)

2.Përgatitni Bilancin Vërtetues të korigjuar (13 pikë)

ZGJIDHJE -----DETYRA 2

a) Regjistrimet në ditar

		Debi	Kredi
		Eur	Eur
i)	LL/A (Aurora)	720	
	Të hyrat nga shitja		720
ii)	Automjetet	15,000	
	Blerjet		15,000
iii)	Blerjet	600	
	LL/P (Amelia)		600
iv)	Paraja e gatshme	40	
	Shpenzimet motorike		40
v)	LL/A	1,000	
	Të hyrat nga shitja		1,000
vi)	Paraja e gatshme	9	
	Shpenzimet e përgjithshme		9
vii)	Makineria	8,500	
	Shpenzimet e riparimit		8,500

b)

Avioni
Bilanci Vërtetues më 30 prill 2021

	Debi	Kredi
Të hyrat nga shitja (134,200 + 720 + 1,000)		135,920
Blerjet (62,300 - 15,000 + 600)	47,900	
Stoqet më 1 maj 2020	4,700	
Zbritjet e marra		390
Zbritjet e lejuara	240	
Shpenzimet e pagave	12,700	
Shpenzimet e qerasë	8,100	
Shpenzimet motorike (7,500 - 40)	7,460	
Shpenzimet e riparimit (14,200 - 8,500)	5,700	
Shpenzimet e përgjithshme (2,600 - 9)	2,591	
Makineritë me kosto (45,000 + 8,500)	53,500	
Zhvlerësimi i akumuluar për makineritë më 1 Maj 2020		8,000
Automjetet me kosto	45,000	
Zhvlerësimi i akumuluar për automjetet më 1 Maj 2020		6,000
Banka	4,449	
Llogaritë e arkëtueshme (4,600+720+1,000)	6,320	
Llogaritë e pagueshme (2,200+600)		2,800
Tërheqjet	7,400	
Kapitali më 1 Maj 2020		<u>52,950</u>
TOTALI	206,060	206,060

DETYRA 3

Në vijim janë paraqitur të dhënat për Cimenti shpk:

Pasqyra e pozicionit financiar më:

	2022	2021
	Eur `000	Eur `000
<i>Pasuritë</i>		
Pasuritë jo qarkulluese	1,295	810
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	1,500	500
Llogaritë e arkëtueshme	2,680	890
Banka	-	740
Total pasuritë	<u>5,475</u>	<u>2,940</u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
Kapitali aksionar	600	400
Fitimet e mbajtura	<u>1,625</u>	<u>600</u>
Total ekuiteti	<u>2,225</u>	<u>1,000</u>
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
10% Obligacione	160	360
<i>Detyrimet afatshkurta</i>		
Mbitërheqja bankare	1,810	-
Llogaritë e pagueshme	955	600
Interesi i pagueshëm	45	80
Tatimi i pagueshëm	<u>280</u>	<u>900</u>
Total detyrimet	<u>3,250</u>	<u>1,940</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	<u>5,475</u>	<u>2,940</u>

Informatat shtesë:

- i) Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022 tregonte këto shuma:

Eur 000

Fitimi operativ	1,531
Shpenzimet e interesit	<u>(26)</u>
Fitimi para tatimit	1,505
Shpenzimet e tatimit	<u>(480)</u>
Fitimi neto	<u>1,025</u>

- ii) Shpenzimet e zhvlerësimit ishin 395,000 eur.

- iii) Gjatë vitit ishin shitur pasuritë afatgjatë me Vlerë neto në libra prej 200,000 eur për 190,000 eur.

Kërkohe:

Përgatini Pasqyrën e Rrjedhës së parasë për Cimenti shpk për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022, sipas kërkesave të SNK 7: Pasqyra e rrjedhave të arkës.

(20 pikë)

ZGJIDHJE DETYRA 3

Cimenti shpk

Pasqyrën e Rrjedhës së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022

	Eur'000	Eur'000
<i>Aktivitetet operative</i>		
Fitimi para interesit dhe tatimit		1,531
Korrigjimet për:		
Zhvlerësimin	395	
Humbja kapitale (200 - 190)	10	
Rritja në stoqe (1,500 - 500)		(1,000)
Rritja në LL/A (2,680 - 890)		(1,790)
Rritja në LL/P (955 - 600)	355	
Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet	(499)	
Interesi i paguar (LL1)	(61)	
Tatimi i paguar (LL2)	(1,100)	
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		(1,660)
<i>Aktivitetet investuese</i>		
Blerja e pasurive jo qarkulluese (LL3)	(1,080)	
Shitja e pasurisë jo qarkulluese		190
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(890)
<i>Aktivitetet financuese</i>		
Emetimi i aksioneve (600 - 400)	200	
Pagesa e obligacioneve	(200)	
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		0
Rrjedha neto e parasë gjatë vitit		(2,550)
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët në fillim		<u>740</u>
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët në fund		<u>(1,810)</u>

LLogaritjet:

1.	Interesi i pagueshëm		
	Eur'000	Eur'000	
Interesi i paguar (sh. balancuese)	61	Saldo në fillim	80
Saldo në fund	45	Shpenzimet	26
	<u>106</u>		<u>106</u>

2.

Tatimi i pagueshëm

	'000		'000
Tatimi i paguar(sh.balancuese)	1,100	Saldo në fillim	900
Saldo në fund	280	Shpenzimet	480
	<u>1,380</u>		<u>1,380</u>

3.

Pasuritë jo qarkulluese
VNL

	'000		'000
Saldo në fillim	810	Shitjet	200
Blerjet (sh.bal)	1,080	Zhvleresimi	395
	<u>1,890</u>	Saldo në fund	1,295
			<u>1,890</u>

DETYRA 4

Bilanci vërtetues i paraqitur në vijim, është nxjerr nga librat e kompanisë Nita shpk më 31 dhjetor 2022:

	Eur	Eur
Toka	251,200	
Pajisjet (Kosto)	202,220	
Zhvlerësimi i akumuluar i pajisjeve		62,830
Stoqet në fillim	49,620	
Llogaritë e arkëtueshme	124,200	
Llogaritë e pagueshme		104,350
Parapagimet e sigurimit	10,320	
Të arkëtueshmet tjera	17,900	
Paraja e gatshme	15,640	
Lejimet për borxhet e dyshimta		11,250
Tatimi i pagueshëm		7,420
Shpenzimet e qerasë	30,000	
Të hyrat nga shitja		804,500
Blerjet	390,200	
Zbritjet e lejuara	8,300	
Kthimet e blerjeve		7,500
Shpenzimet e marketingut	4,300	
Zbritjet e marra		6,240
Shpenzimet e shpërndarjes	8,900	
Shpenzimet e energjisë elektrike	4,200	
Shpenzimet komunale	1,540	
Shpenzimet e sigurimit	22,500	
Shpenzimet e pagave	164,380	
Shpenzimet e telefonit	16,560	
4% Kredia afatgjatë		182,500
Shpenzimet e zyrës	3,520	
Borxhet e këqija	2,240	
Tërheqjet	10,580	
Fitimet e mbajtura		44,820
Kapitali i pronarit		103,710
Llogaria pezull		3,200
	1,338,320	1,338,320

Informatat shtesë:

- i) Stoqet në fund të vitit ishin 42,390 Eur.
- ii) Një faturë e qerasë shtesë e pa paguar nuk është regjistruar në shumë prej 40,000 eur.
- iii) Në shpenzimet e sigurimit është përfshirë një shumë prej 18,000 eur e cila ishte paguar për të siguruar një pajisje. Polica e sigurimit mbaron më 28 shkurt 2023.
- iv) Kompania ka dyshim se do të arketojë një borxh nga klienti prej 5,120 eur dhe dëshiron të bëjë një lejim për të. Duhet të ndahet lejim i përgjithshëm prej 5%. Borxhet e këqija tani më janë regjistruar.
- v) Zhvlerësimi ndahet si në vijim:

Pajisjet 15% metoda e saldove zbritëse.

- vi) Llogaria pezull në bilancin vërtetues lidhet me një shitje prej 1,600 eur, e cila ishte regjistruar gabimisht si blerje. Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme janë të sakta, nuk ka nevojë për korigjim.
- vii) Duhet të kalkulohen shpenzimet e interesit të kredisë afatgjatë.

Kërkohe:

- a) Përgatitni Pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022. **(10 pikë)**
- b) Përgatitni Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022. **(10 pikë)**

(Totali: 20 pikë)

Zgjidhje 4

KALKULIMET:

i) St në fillim	49,620
Blerjet	390,200
Korrigjimi	-1,600
<u>Blerjet e korrigjuara</u>	<u>+388,600</u>
Kthimet e blerjeve	-7500
<u>St në fund</u>	<u>-42,390</u>

KMSH =388,330

ii) D: Shpenzimet e qerasë 40,000
K: Qeraja e pagueshme 40,000

iii) $18,000/12 \text{ muaj}=1,500 \text{ në muaj}$
 $1,500*2 \text{ muaj (Janar, shkurt 2023)}=3,000 \text{ janë parapagime}$

D:Parapagimet 3,000
K:Shpenzimet e sigurimit 3,000

iv) $\text{Lejimet}=(124,200-5,120)*5\%=5,954$
 $\text{Total lejimet}=5,954+5,120=11,074$
 $\text{Rënia në lejime}=11,250-11,074=176$

D: Lejimet 176
K:Të hyrat nga borxhet e dyshimta 176

v) $\text{Shpenzimet e zhvlerësimit}=15\%*(202,220-62,830)= 20908.5$

vi)Saktë

D:LL/A 1,600
K:Shitjet 1,600

Gabim:

D:Blerjet 1,600

D:LL/A 1,600

K:Llogaria pezull 3,200

Korrigjim:

D:Llogaria pezull 3,200

K: Blerjet 1,600

K:Shitjet 1,600

vii) $\text{Shpenzimet e interesit}=182,500*4\%=7,300$

D:Shpenzimet e interesit 7,300

K:Interesi i pagueshëm 7,300

**Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor
2022**

Të hyrat nga shitja	804,500	+1,600	806,100
<u>KMSH</u>			<u>(388,330)</u>
Fitimi bruto			417,770
Të hyrat tjera			
Zbritjet e marra			+6,240
Të hyrat nga borxhet e dyshimta			+176
Shpenzimet operative:			
Shpenzimet e qerases			(70,000) 30,000+40,000
Shpenzimet e marketingut			(4,300)
Shpenzimet e shpërndarjes			(8,900)
Shpenzimet e energjisë elektrike			(4,200)
Shpenzimet komunale			(1,540)
Shpenzimet e sigurimit			(19,500) 22,500-3,000
Shpenzimet e pagave			(164,380)
Shpenzimet e telefonit			(16,560)
Shpenzimet e zyres			(3,520)
Shpenzimet e borxheve të këqija			(2,240)
Zbritjet e lejuara			(8,300)
<u>Shpenzimet e zhvlerësimit</u>			<u>(20,908.5)</u>
Fitimi para interesit dhe tatimit			99,837.5
<u>Shpenzimet e interesit</u>			<u>7,300</u>
Fitimi neto			92,537.5

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022

Toka	251,200	
Pajisjet (Kosto)	202,220	
<u>Zhvierësimi i akumuluar i pajisjeve</u>	<u>83,738.50</u>	<u>(62,830+20,908.5)</u>
VNL e pajisjeve	118,481.50	
<i>Total pasuritë jo qarkulluese</i>	<i>369,681.50</i>	
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	42,390.00	
LL/A	124,200.00	
<u>Lejimet</u>	<u>(11,074.00)</u>	
LL/A neto	113,126.00	
Të arkëtueshmet tjera	17,900.00	
Parapagimet e sigurimit	13,320.00	(10,320+3,000)
Paraja e gatshme	15,640.00	
<i>Total pasuritë qarkulluese</i>	<i>202,376.00</i>	
TOTAL PASURITE		572,057.50
EKUITETI		
Kapitali i pronarit	103,710.00	
Fitimet e mbajtura në fillim	44,820.00	
Fitimi neto	92,537.50	
Tërheqjet	(10,580.00)	
TOTAL EKUITETI		230,487.50
DETYRIMET		
Detyrimet afatgjata		
4% Kredia afatgjatë	182,500.00	
Detyrimet afatshkurta		
Llogaritë e pagueshme	104,350.00	
Tatimi i pagueshëm	7,420.00	
Qeraja e pagueshme	40,000.00	
Interesi i pagueshem	7,300.00	
<i>Totali i detyrimeve afatshkurta</i>	<i>159,070.00</i>	
TOTAL DETYRIMET		341,570.00
TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET		572,057.50

DETYRA 5

Presheva është kompania mëmë e Nartit. Më poshtë janë pasqyrat e pozicionit financiar për të dy kompanitë më 31 Tetor 2022.

	<i>Presheva</i>		<i>Narti</i>	
	€'000	€'000	€'000	€'000
<i>Pasuritë</i>				
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>				
Prona, pajisjet dhe impiantet		4,200		3,300
Investimet: aksionet në Narti sipas kostos		3,345		-
<i>Pasuritë qarkulluese</i>				
Stoqet	1,500		800	
Llogaritë e arkëtueshmet	1,800		750	
Paraja në bankë	<u>600</u>		<u>350</u>	
		<u>3,900</u>		<u>1,900</u>
<i>Gjithsej pasuritë</i>		<u>11,445</u>		<u>5,200</u>
<i>Detyrimet dhe Ekuiteti</i>				
<i>Ekuiteti</i>				
€1 Aksionet e zakonshme		9,000		4,000
Fitimet e mbajtura		<u>525</u>		<u>200</u>
		9,525		4,200
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>				
Llogaritë e pagueshme		1,220		200
Tatimi		<u>700</u>		<u>800</u>
<i>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti</i>		<u>11,445</u>		<u>5,200</u>

Informacioni i mëposhtëm është gjithashtu i disponueshëm.

- Presheva bleu 2,800,000 aksione në Narti një vit më parë kur Narti kishte fitimin e mbajtur €60,000. Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në datën e blerjes ishte €1,415,000.
- Gjatë vitit Presheva shiti mallra me një vlerë fature prej €240,000 për Nartin. Këto mallra janë faturuar me shtim mbi kosto 20%. Gjysma e mallrave janë ende në inventarin e Nartit në fund të vitit.
- Narti i detyrohet Preshevës €30,000 më 31 Tetor 2022 për mallrat e blera gjatë vitit.

Kërkohet

- Llogaritni emrin e mirë në blerje. **(5 pikë)**
- Përgatitni pasqyrën e konsoliduara të pozicionit financiar për grupin Prestend më 31 Tetor 2022.

Shënimet shpjeguese nuk janë të nevojshme.

(15 pikë)
[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e detyrës 5

(a) Llogaritja e emrit të mirë për blerjen e Nartit

	€	€'000
Vlera e drejtë e konsiderates së transferuar		3,345
Plus vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në blerje		1,415
Minus vlera e drejtë e blerjes neto e pasurive të identifikueshme dhe detyrimeve të marra:		
Kapitali aksionar i zakonshëm	4,000	
Fitimet e mbartura në blerje	<u>60</u>	
		<u>(4,060)</u>
Emri i mirë		<u>700</u>

(b) Grupi Presheva

PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZITËS FINANCIARE MË 31 Tetor
2022

	€'000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Emri i mirë	700	
Pasuritë e prekshme jo-qarkulluese (4,200 + 3,300)	<u>7,500</u>	
		8,200
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet (1,500 + 800 - 20 (LL2))	2,280	
Llogaritë e arkëtueshme (1,800 + 750 - 30)	2,520	
Paraja në bankë (600 + 350)	<u>950</u>	
		<u>5,750</u>
		<u>13,950</u>
<i>Detyrimet dhe Ekuiteti</i>		
<i>Ekuiteti</i>		
€1 Aksionet e zakonshme		9,000
Fitimet e mbajtura (LL3)		603
Interesit jo-kontrollues (LL4)		<u>1,457</u>
		<u>11,060</u>
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Llogaritë e pagueshme (1,220 + 200 - 30)	1,390	
Tatimi (700 + 800)	<u>1,500</u>	
		2,890
<i>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti</i>		<u>13,950</u>

Llogaritjet

1 Struktura e grupit

$$\frac{2,800,000}{4,000,000} = 70\% \quad \left| \begin{array}{l} \text{Presheva} \\ \text{Narti} \end{array} \right.$$

2 Fitimi i porealizuar në shitjet brenda grupit

$$\text{Fitimi në shitjen brenda grupit është } €240,000 \times \frac{20}{120} = €40,000$$

$$\therefore \text{Fitimi i porealizuar është } €40,000 \times 50\% = €20,000$$

3 Fitimet e mbajtura

	Presheva	Narti
	€'000	€'000
Sipas pyetjes	525	200
Rregullimi (fitimi i porealizuar (LL2))	(20)	
Fitimet e mbajtura para blerjes		(60)
		<u>140</u>
Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura pas blerjes:		
Northon (70% × 140)	<u>98</u>	
Fitimet e mbajtura të grupit	<u>603</u>	

4 Interesi jo-kontrollues

Vlera e drejtë e interesit jo-kontrolluese në blerje	1,415
Plus pjesa e interesit jo-kontrollues të fitimeve të mbajtura pas blerjes (30% × 140)	<u>42</u>
Interesi jo kontrollues në datën e raportimit	<u>1,457</u>